



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

INDEKSI KOSOVAR I REZILIENCËS

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË KOSOVË: ÇFARË MUND TË MËSOJMË NGA REZILIENCA NË KOMUNITET?



Botues: Kosovar Centre for Security Studies

Autorë: Skënder Perteshi

Edituar nga: Florian Qehaja-QKSS, Garentina Kraja-QKSS

Mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Prishtinë nëpërmjet programit MATRA.



Kingdom of the Netherlands

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Opinionet e prezantuara në këtë hulumtim janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë opinionet e Ambasadës e Mbretërisë së Holandës dhe Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë.



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

INDEKSI KOSOVAR I REZILIENCËS

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË KOSOVË: ÇFARË MUND TË MËSOJMË NGA REZILIENCA NË KOMUNITET?

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	6
HYRJE	7
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	9
Pse janë përzgjedhur këta indikator për studim?	10
Rezilienca shoqërore: Çfarë dijmë dhe pse e nevojshme?	12
Si vlerësohet rezilienca shoqërore?.....	15
Kufizimet e hulumtimit	15
1. KOHEZIONI SHOQËROR DHE IDENTITETI	16
1.1 Ndjenja ndaj komunitetit.....	17
1.2 Stigma dhe Diskriminimi	19
1.3 Fuqia e familjes si instrument i reziliencës shoqërore	22
1.4 Toleranca ndaj etnisë tjetër	26
1.5 Toleranca ndaj racës tjetër.....	27
1.6 Toleranca fetare	29
1.7 Identiteti dhe rezilienca	31
2. BESIMI NË SHTET DHE LIDHJA ME KOSOVËN	34
2.1 Besimi në shtet dhe migrimi.....	34
Migrimi dhe rezilienca	37
3. BASHKËJETESA FETARE NË KOSOVË	39
3.1 Liritë fetare dhe bashkëjetesë ndërmjet feve.....	39
3.2 Besueshmëria në bashkësitë fetare.....	40
REKOMANDIMET.....	43

BIOGRAFIA E AUTORIT

Skënder Perteshi ka diplomuar për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci në Kolegjin Universitar “Universum”. Skënderi punon si hulumtues për QKSS-në dhe udhëheq programin e QKSS-së për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimin e tij. Ai është autor dhe bashkautor i shumë raporteve hulumtuese lidhur me tema të sigurisë si: kundërvënia ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm; integriteti në Sektorin e Sigurisë në Kosovë dhe ndërtimi i komuniteteve të qëndrueshme në Kosovë. Skënderi ka punuar edhe si bashkëpunëtor dhe konsulent i lartë për tema të lidhura me sigurinë për organizata ndërkombëtare dhe lokale si: Fondacioni i Ndihmës së Kishës Finlandeze - Helsinki, Instituti RUSI, Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM), OSBE, MOONSHOT Londër dhe organizata të tjera.

LISTA E SHKURTESAVE

BE	Bashkimi Evropian
BIK	Bashkësia Islame e Kosovës
BKS	Barometri Kosovar i Kosovës
BTK	Bashkësia e Tarikateve të Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
KFOR	Forca për Kosovën
NATO	Aleanca Veri-Atlantike
OJQ	Organizatat Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PK	Policia e Kosovës
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
VRSH	Vlerësimi i Reziliencës Shoqërore
PEDHSHP	Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm që Shpie në Terrorizëm

HYRJJE

Nga viti 2011 Kosova është përballur me sfida të mëdha në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Si shkak i përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit dhe si rrjedhojë e zhvillimit të luftërave të huaja në Siri dhe Irak, qindra qytetar të Kosovës iu bashkuan këtyre konflikteve. Përpyekjet institucionale ishin fokusuar kryesisht në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm duke u fokusuar në parandalimin e individëve që t'u bashkohen luftërave të huaja si dhe ndjekjen penale të atyre që rekrutuan qytetarë tanë që tu bashkohen konflikteve të huaja.

Në këtë kohë nuk është menduar për reziliencën apo rolin e reziliencës në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Rezilienca apo qëndrueshmëria është çështje e re dhe e pa analizuar rreth efektit të saj në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Nëpërmjet këtij hulumtimi ne kemi bërë vlerësimin e reziliencës së komunitetit kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit si dhe është bërë identifikimi i faktorëve që rrisin reziliencën e komunitetit ndaj formave të ndryshme të ekstremizmit dhe radikalizmit.

Për matjen e reziliencës së komunitetit ndaj ekstremizmit dhe radikalizmit janë trajtuar 3 indikator si: identiteti dhe kohezioni social, lidhja me vendin dhe besimi në institucionet e shtetit si dhe harmonia fetare ndërmjet komuniteteve në vend. Nëpërmjet vlerësimit të këtyre indikatorëve ne kemi identifikuar pikat e forta të reziliencës së komunitetit në Kosovë, të cilat duhet të punohen me qëllim të krijimit të komuniteteve reziliente kundër dhunës dhe radikalizmit.

Ky hulumtim konstaton se ka një kohezion të mirë social brenda komuniteteve që kanë bindje të ndryshme fetare dhe që u takojnë etnive të ndryshme. Komunitetet në Kosovë i besojnë njëri tjetrit si dhe ka një bashkëpunim shumë të mirë brenda komuniteteve. Megjithatë, mungon një bashkëpunim dhe ndërveprim ndërmjet komunitetit dhe institucioneve të shtetit në nivel qendror dhe lokal në Kosovë.

Qytetarët kanë besim të ulët ndaj nivelit komunal si dhe institucioneve në nivel qendror në Kosovë. Kjo përbën një shqetësim për faktin se mungesa e ndërveprimit ndërmjet komunitetit dhe institucioneve të shtetit krijon një hapësirë më të madhe për rritje të pasigurisë në vend, si dhe krijon ambient të përshtatshëm për përhapjen të dhunës dhe radikalizmit.

Harmonia fetare mbetet ndër vlerat kryesore me të cilat identifikohet shoqëria kosovare e cila ka ndihmuar vendin në parandalimin e përhapjes me të madhe të elementeve radikale fetare në vend. Përderisa ka një harmoni të shkëlqyer ndërmjet komuniteteve që u takojnë feve të ndryshme, sfidë mbetet përplasja e sekteve apo grupeve të ndryshme brenda komunitetit të besimit islam në vend, sidomos brenda Bashkësisë Islame në Kosovë (BIK). Një përplasje e tillë ka armiqësuar komunitetin praktikues islam në vend si dhe ka krijuar trupa paralele religjioze në vend.

Identiteti kombëtar apo shprehja e ndjenjës kombëtare mbetet shumë e fortë në Kosovë dhe se komuniteti ndihet shumë krenar me përcaktimin e identitetit të tij kombëtar. Sfidë mbetet krijimi i hapësirës për të shprehur lirshëm ndjenjat fetare apo orientimin politik. Të anketuarit deklaruan se në vend nuk ka liri të mjaftueshme për të shprehur lirshëm orientimin e tyre politik, identitetin apo ndjenjën e tyre fetare. Një situatë e tillë është shqetësuese për faktin se mungesa e lirisë për të shprehur orientimin politik apo ndjenjën fetare krijon një ambient të përshtatshëm për diskriminim dhe stigmë të komuniteteve të cënueshme nga ekstremizmi apo radikalizmi në vend.

Kosova përballet me sfida të mëdha të cilat kanë penguar zhvillimin vendit si dhe ngritjen e cilësisë së jetesës së qytetarit të cilat shpien në rritjen e pasigurisë së shoqërisë kosovare për një jetë më të mirë në Kosovë. Mungesa e pasigurisë tek qytetarët ndikoi që shoqëria kosovare të kërkojë alternativë për një jetë më të mirë duke migruar në vendet e Evropës Perëndimore. Sfidat si korrupsioni, krimi i organizuar, sistemi i dobët i edukimit e shëndetësisë, mungesa e sundimit të ligjit dhe qeverisja e keqe kanë krijuar një ambient të humbjes së shpresës së qytetarëve për një jetë më të mirë në vend si dhe kanë rritur nivelin e cënueshmerisë së komunitetit ndaj ekstremizmit dhe radikalizmit në vend.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për hartimin e këtij raporti, QKSS ka zbatuar një sërë teknikash të mbledhjes së të dhënave cilësore dhe sasore.

Gjetjet e Barometrit Kosovar të Sigurisë¹ të realizuar në tetor të vitit 2019 lidhur me reziliencën e komuniteteve në Kosovë kanë qenë qenësore në përgatitjen e këtij raporti. Hulumtimi i Barometrit në terren bazohet në Anketën e kryer me 1200 respondent nëpër të gjitha komunat e Kosovës, duke përfshirë edhe nivelin urban dhe rural të vendbanimeve. Qytetarët janë pyetur pikëpamjet tyre për çështjet që ndërlidhen me sigurinë, besimin në institucionet e shtetit, kohezionin social dhe identitetin, lidhjen e tyre me Kosovën si dhe si dhe bashkëpunimin me komunitetin dhe institucionet e shtetit. Poashtu, edhe çështjet të cilat lidhen me harmoninë fetare etnike dhe racore kanë qenë pjesë e këtij vlerësimi.

Grupet e Fokusit kanë kontribuar mjaftë shumë në mbledhjen e të dhënave për përpilimin e raportit. Janë organizuar pesë grupe të fokusit me përfaqësues të komunitetit nga rajonet e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Ferizajit, Gjilanit dhe Mitrovicës. Pjesëmarrësit në fokus grup kanë qenë të moshave e profleve të ndryshme të edukimit si dhe ka pasur përfaqësim të barabartë gjinor tek pjesëmarrësit. Në mesin e pjesëmarrësve kishte përfaqësues të institucioneve shtetërore, OJQ-ve, përfaqësues të bashkësive fetare, aktivist qytetar, sektori i edukimit, biznesit si dhe përfaqësues tjerë.

Për përgatitjen e këtij raporti janë analizuar një numër i madh i raporteve ndërkombëtare të cilat kanë trajtuar reziliencën në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit. Janë analizuar raporte të instituteve akademike dhe universiteteve të cilat kanë trajtuar këtë fenomen. Ishte e pamundur konsultimi i raporteve vendore për reziliencën për shkak të mungesës së literaturës dhe analizës e cila e trajton nivelin e reziliencës ndaj formave të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë.

1 Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i QKSS i cili është themeluar në Shtator 2012. Ky program ka për qëllim implementimin e metodave kuantitative hulumtuese në QKSS. Pra, për dallim nga programet e tjera të cilat janë të ndërlidhura kryesisht me sektorin apo sferën të cilin e mbulojnë, KSB është programi vetëm i QKSS i cili është i bazuar kryekëput në metodologjinë unike të cilën e zbaton. Në edicionin e vitit 2019 është matur edhe niveli i reziliencës së komuniteteve në Kosovë rreth dhunës, radikalizmit dhe ekstremizmit.

Janë intervistuar mbi 15 përfaqësues të nivelit lokal dhe qendror duke përfshirë përfaqësues të institucioneve lokale, udhëheqës lokal, bashkësitë fetare në Kosovë, aktivist të shoqërisë civile si dhe përfaqësues tjerë të komunitetit.

Ky raport ka bërë matjen e nivelit të reziliencës së komunitetit, formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, me fokus të theksuar tek ekstremizmi i dhunshëm islamik i cili kishte një rritje të madhe në 10 vitet e fundit dhe prej të cilit komuniteti në Kosovë është prekur e cila rezultoi me një numër të madh të qytetarëve të vendit të cilët udhëtuan në konfliktet në Siri dhe Irak. Më poshtë do të spjegohen arsyet pse janë zgjedhur tre indikatorët për vlerësimin e reziliencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

PSE JANË PËRZGJEDHUR KËTA INDIKATOR PËR STUDIM?

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) për vite më radhe ka analizuar e pastaj identifikuar disa prej shkaktarëve më të rëndësishëm të përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë. Hulumtimet e QKSS-së tregojnë se kapja e shtetit, korrupsioni, mungesa e lirisë së besimit dhe praktikimit krijuan një ambient të përshtatshëm për përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë.² Shkaktarët tjerë kryesor të përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm në nivel individual e komunitar në Kosovë ishin ndjenja e përkatësisë, përhuajësimi, ri-islamizimi, vakumi identitar, prejardhja familjare dhe lidhjet familjare me personat e radikalizuar.³ Të gjithë këta shkaktarë të përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë, indikator të cilët janë trajtuar në këtë raport edhe në raport me rolin e këtyre indikatorëve dhe ngritjes së qëndrueshmërisë së komunitetit kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Pra të dhënat e zberthyer në raport synojnë të ofrojnë përgjigje rreth pozicionit dhe perceptimit të qytetarëve të Kosovës për shkaktarët e përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm në vend. Për më shumë, ky raport do të sjellë një pasqyrë më të mirë të pikave të forta të komunitetit, të cilat bëjnë që komuniteti të jetë imun ndaj dhunës e ekstremizmit të dhunshëm në vend.

2 Shpend Kursani "Report inquiring into the causes and consequences of Kosovo citizens' involvement as foreign fighters in Syria and Iraq" KCSS 2015.

3 Kosovo Report "Violent Extremism in Western Balkans" Extremism Research Forum 2018 https://www.britishcouncil.ba/sites/default/files/erf_report_western_balkans_2018.pdf

Ky raport nuk eliminon çështjet e edukimit, punësimit dhe gjendjen e rëndë ekonomike e sociale si shkaktar të përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në vend, mirëpo nuk i vendos si faktorët qëndror të përhapjes së ekstremizmit dhe radikalizmit. Për më shumë, duke pasur parasysh vet përkufizimin e reziliencës shoqërore, faktorët e karakterit joekonomik konsiderohen të zënë vend qëndror në konditat e reziliencës shoqërore në raport me shtrirjen e ideologjive negative siç janë ato të cilat manifestohen në forma radikale apo ekstreme.⁴

Në fakt, lidhur më aspektin e edukimit, të dhënat tregojnë se nëse e krahasojmë nivelin e edukimit të gjithë popullatës së Kosovës dhe atyre që kanë udhëtuar në luftërat e huaja në Siri dhe Irak, nuk vërehet ndonjë dallim i madh. Sipas të dhënave, individët të cilët kanë udhëtuar në Siri dhe Irak, për një shkallë janë më lartë në nivelin e edukimit sekondar për dallim nga të dhënat e përgjithshme të popullatës në vend.⁵

Siç paraqitet në grafën më poshtë, mesatarisht, niveli dytësor i arsimit është rreth 10 përqind më i lartë në mesin e luftëtarëve të huaj sesa mesatarja e Kosovës.⁶ Pra, niveli i edukimit të luftëtarëve të huaj dhe krahasimi i tyre me mesatarën e Kosovës nuk na jep asnjë ndërlidhje ndërmjet nivelit të edukimit si dhe ndikimit të tij në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm në vend. Rrjedhimisht, niveli më i lartë i edukimit nuk do të konsiderohej faktorë esencial i reziliencës shoqërore veçanërisht në kontekstin e Kosovës.

Në fakt, çështja nuk qëndron në kualifikimet arsimore veçse në cilësinë e edukimit në tërësi duke përfshirë këtu cilësinë e informacioneve që të rinjtë tanë i përfitojnë përgjatë procesit të edukimit në Kosovë. Sistemi jonë i edukimit nuk ofron hapësirë për zhvillimin e mendimit kritik si faktor i reziliencës, si dhe gjykim më të mirë të informacioneve të cilat ata përfitojnë, qoftë në shkolla, media sociale, libra të cilat mund të jenë esenciale në luftimin e të gjitha formave të ekstremizmit dhe paragjytimeve dhe forcimin e reziliencës.

4 RAN- Centre for Excellence 2016 https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_root-causes_jan2016_en.pdf

5 Kosovo Report "Violent Extremism in Western Balkans" Extremism Research Forum 2018 https://www.britishcouncil.ba/sites/default/files/erf_report_ëestern_balkans_2018.pdf

6 Ibid:

Në anën tjetër, kushtet ekonomike të luftëtareve të huaj të cilët kanë marrë pjesë në luftërat në Siri dhe Irak mund të ndikojnë në përhapjen ekstremizmit të dhunshëm, por nuk vlerësohen si shkaktar qendror.⁷

Nëse i krahasojmë të ardhurat e luftëtarëve të huaj nga Kosova me nivelin e të ardhurave të popullatës së vendit, nuk vërehen dallime të mëdha. Matja e nivelit të të ardhurave të kësaj kategorie si dhe niveli i punësimit të tyre nuk e shpjegojnë përhapjen e radikalizmit apo ekstremizmit të dhunshëm për shkak se në mesin e luftëtarëve të huaj kemi individë të cilët vijnë nga të gjitha shtresat e shoqërisë, të pasur, të varfër apo ata me kushte mesatare ekonomike. Mirëpo, niveli i ulët i punësimit dhe investimeve tek komunitetet e cenushme nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm mund të krijoj një ambient fertil për përhapjen e ekstremizmit dhe radikalizmit në nivel të komuniteti.

REZILIENCA SHOQËRORE: ÇFARË DIJMË DHE PSE E NEVOJSHME?

Rezilienca shoqërore – apo siç njihet në gjuhën angleze “resilience” – paraqet një ndër konceptet më të përmendura rishtazi në kontekstin e politikave bashkëkohore publike.⁸ Deri më tani nuk ka ndonjë pajtueshmëri në qarqet hulumtuese e akademike për definicionin rreth rreziliencës. Në fakt, kontestet në zbërthim të këtij koncepti nuk konsistojnë vetëm në aspektin substancial por edhe në faktin që në gjuhët tjera përveç në anglisht nuk ka ndonjë fjalë e cila mund të përkthehet tekstualisht. Sipas fjalorit të Oxford, rezilienca shoqërore (resilience) “është aftësia e njerëzve apo gjërave që të ripërtërihen shpejt pas ndonjë ndodhie [të keqe]”.⁹ Në aspektin akademik, rezilienca është studiuar mjaft shumë ku ndër të tjera studiuësja nga Syracuse University Patricia Longstaff e definon atë si “aftësinë e shoqërisë për të përvetësuar apo tu përballur me shqetësimin, ndryshimet e papritura, si dhe në të njëjtën kohë duke ruajtur funksionet bazë të saj si identitetin dhe strukturën e saj.”¹⁰ Definicion të përafërt rreth përkufizimit të reziliencës ka edhe studiuësja Ami Carpetner, e cila e definon atë si “aftësinë

7 Skender Perteshi “Përtej shkaktarëve: Rreziqet e reja të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë” QKSS, Prishtinë 2018

8 Gjuha shqipe nuk ka ndonjë term që i përgjigjet drejtpërsëdrejti termit “resilience”. Megjithatë përkufizimi më i përafërt do të ishte rezistencë apo ripërtitje shoqërore mirëpo ekipi hulumtues ka vendosur ta mbaj konceptin fjalëpërfjalë ‘resiliencë’ duke këmbyer në disa vende me ripërtitje shoqërore/rezistencë varësisht nga përshtatja.

9 <https://www.oxfordlearnersdictionaries.com/definition/english/resilience>

10 Longstaff, P. H., Armstrong, N. J., Perrin, K., Parker, W. M., & Hidek, M. A. (2010). Building resilient communities: A preliminary framework for assessment. Homeland Security Affairs, 6(3).

e sistemeve shoqërore për të përvetësuar ndonjë të papritur apo shqetësim shoqëror, duke ruajtur funksionet bazike të saj, identitetin dhe strukturën”.¹¹

Studiuesja tjetër Lauren Van Metre ka dhënë një përkufizim edhe më të kompletuar lidhur me reziliencën e komunitetit. Sipas saj “reziliencia është aftësia e komunitetit, shtetit apo rajonit që tu përshtaten proceseve dhe normave të reja, si dhe strategjitë për zhvillimin e jetës së tyre në marrëdhëniet e reja shoqërore si përgjigje ndaj ndonjë tronditje ose agresioni të dhunshëm, në mënyrë që të parandalohen, dhe tejkalojmë dhunën.¹² Këtu përfshihen gjendja aktuale e komunitetit në dukuritë si kohezioni social dhe vakumi identitar, siguria dhe besimi në shtet, si dhe bashkëjetesa fetare ¹³, dukuri të cilat janë trajtuar nga ky hulumtim në rastin e Kosovës.

Lidhur me përkufizimin e reziliencës shoqërore, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, z. Ban Ki Moon, në vitin 2016, në Planin e Veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm të vitit 2016 të OKB-së nuk e përmend fare reziliencën shoqërore si përkufizim, dhe sipas tij, kjo çështje është e hapur, duke ua lënë vendeve të vendosin për kuptimin apo kontekstualizimin e saj.¹⁴ Megjithatë, koncepti si i tillë po vazhdon të zërë vend në dokumente strategjike e doktrino-re të vendeve të ndryshme përfshirë këtu ato të Bashkimit Evropian (BE) dhe Aleancës Veri-Atlantike (NATO).

Në anën tjetër, koncepti si i tillë nuk është e paraparë as në legjislacionin e Kosovës apo edhe në strategjinë kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm që Shpie në Terrorizëm. Në fakt kjo strategji, në hyrje të saj përmend “qëndrueshmërinë” si pjesë e qëllimit të strategjisë që është parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, strategjia nuk e trajton si temë të vecantë reziliencën, dhe nuk është e qartë se a është menduar qëndrueshmëria në kontekst të përkufizimit të reziliencës shoqërore (rezilience) apo si një definim tjetër. Strategjia e PEDHSHP thekson se “ngjarjet që kanë ndodhur në vitet e fundit në Kosovë, Evropë, Lindjen e Mesme (2001-2015) dhe më gjerë e kanë bërë të qartë nevojën dhe interesin e Republikës së Kosovës që të hartoj një strategji përmes të cilës do të koordinohen masat në forcimin e *qëndrueshmërisë* së shtetit dhe shoqërisë ndaj kërcënimeve që

11 Carpenter, A. C. (2014). Resilience: Conceptual Foundations. In *Community Resilience to Sectarian Violence in Baghdad* (pp. 63-80). Springer New York

12 Lauren van Metre <https://www.usip.org/sites/default/files/PË121-Peacebuilding-and-Resilience-How-Society-Responds-to-Violence.pdf>

13 Ibid.

14 UN secretary General's Plan of Action to Prevent Violent Extremism (2016)

vijnë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm”.¹⁵ Përbrenda strategjisë, nuk ka ndonjë definicion që shpjegon këtë fenomen në kontekstin e Kosovës, apo aktivitete për të trajtuar rezistencën e individit apo komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm e terrorizmit.¹⁶

QKSS në hulumtimet e saja ka trajtuar çështjet e reziliencës shoqërore në kontekstin e Kosovës, duke u fokusuar në kapacitetin shoqëror për të ju kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Sipas hulumtimeve të QKSS, reziliencia shoqërore ngërthen vetëdijesimin e komunitetit për problemet që atyre ju kanosen dhe veprimet e tyre të përbashkëta në funksion të luftimit të këtij fenomeni. Ajo gjithashtu përfshin qëndrimin e komunitetit ndaj një fenomeni të tillë dhe reagimin e tij pas shfaqjes së aktivitetit të ekstremizmit të dhunshëm, ose ngjarjeve që perceptohen se çojnë në shfaqjen e tij.¹⁷

E kundërta e saj është “cenueshmëria” që reflekton ngurrimin e komunitetit ose mungesën e mobilizimit për të ndërhyrë ose për tu angazhuar në mënyrë aktive në adresimin e ekstremizmit të dhunshëm. Kjo mund të ndodhë për shkak të mungesës së mekanizmave të domosdoshëm për mobilizim, mungesës së nxitjes për të punuar së bashku në nivel të komunitetit, ose tensioneve ndërmjet palëve të interesit që pengojnë adresimin e sfidave në mënyrë gjithëpërfshirëse.¹⁸

Me fjalë të tjera, reziliencia shoqërore nënkupton edhe forcimin e pikave të forta të komunitetit që krijojnë imunitet shoqëror ndaj dhunës apo konfliktit siç janë: besimi në komunitet e shtet, harmonia ndërfetare dhe ndëretnike, tolerance gjinore e racore, kohezioni shoqëror, vakumi identitar dhe krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë.

Reziliencia shoqërore duhet të kuptohet në tre nivele: individual, grupor dhe kombëtar. Në këtë raport në kemi vlerësuar më shumë dy nivelet e para që forcojnë komunitetin (grupin) apo individin kundrejt ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë. Janë analizuar edhe disa prej shkaktarëve të cilët cenojnë individin apo komunitetin në Kosovë.¹⁹

15 Strategjia Kombetare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm 2015 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

16 Ibid.

17 Garentina Kraja dhe Rudine Jakupi “Shpjegimi i dallimit: Cenueshmëria dhe Qëndrueshmëria ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë” QKSS, Prishtine 2018

18 Ibid.

19 Garentina Kraja dhe Rudine Jakupi “Shpjegimi i dallimit: Cenueshmëria dhe Qëndrueshmëria ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë” QKSS, Prishtine 2018

Raporti vlerëson se Kosova si shtet, dhe shqiptarët e Kosovës si etni me shumicë dërmuese janë të rezistueshëm (rezilient) ndaj ideologjive që ndërlidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin. Kjo për shkak të kontekstit të Kosovës, kohezonit të mirë shoqëror, historisë së saj, si dhe mënyrës organike të praktikimit të fesë. Pavarësisht se ekziston një bazë e mirë e reziliencës shoqërore, Kosova ende nuk ofron një ambient të lirë dhe të sigurtë për të shprehur lirshëm orientimin politik apo fetar të individëve apo komuniteteve për shkak të paragjytimeve apo stigmës të shkaktuar nga shoqëria.

SI VLERËSOHET REZILIENCA SHOQËRORE?

Vlerësimi i Reziliencës Shoqërore (VRSH) do të bëhet duke marrë për bazë tre indikatorë si vijon: a.) **identiteti e kohezioni shoqëror** b.) **toleranca tradicionale fetare si dhe c.) Besimi në institucionet shtetërore dhe lidhja me Kosovën**. Këta indikatorë konsiderohen se përputhen me nevojat dhe kontekstin e Kosovës. Indikatorët të tjerë përcjellës të cilët janë vlerësuar në këtë raport lidhen me çështjet e qeverisjes së mirë, forcimin e demokracisë, respektimin e të drejtave të njeriut, zhvillimin e qëndrueshëm si dhe sundimin e ligjit. Të gjithë këto konsiderohen indikatorë gjithëpërfshirës kyç në funksion të luftimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm politik, etnik apo fetar.

KUFIZIMET E HULUMTIMIT

Krijimi i komuniteteve të qëndrueshme dhe arritja e reziliencës shoqërore varen nga shumë faktor. Të tre indikatorët të cilët i kemi përzgjedhur për studim, jo domosdoshmërisht janë të vetmit që do të duhej të bazoheshim. Megjithatë, këta janë vlerësuar ndër më kryesorët bazuar në hulumtimet e bëra rreth shkaktarëve të përhapjes së ekstremizmi të dhunshëm në Kosovë dhe më gjerë. Ne jemi të vetëdijshëm që shumë indikatorë tjerë kanë rol në krijimin e një klime të reziliencës shoqërore në pikën ku do të minimizohej nëse jo eliminohej potenciali radikalizues e ekstremizues. Indikatorët që ne i kemi përzgjedhur për studim janë bazuar në rezultatet e hulumtimit dhe raporteve që kanë trajtuar çështjet e ekstremizmit dhe radikalizmit në Kosovë dhe më gjerë dhe në bazë të rezultateve janë identifikuar edhe shkaktarët kryesor që mund të influencojnë individin apo komunitetin të bëhen pjesë e dhunës apo ekstremizmit të dhunshëm pa u kufizuar në religjion, etni apo atë politik.

1. KOHEZIONI SHOQËROR DHE IDENTITETI

Kohezioni shoqëror dhe identiteti përfshinë pozicionin e individit dhe komunitetit ndaj pjesëtarit të etnisë, orientimit politik apo fesë tjetër. Kohezioni i mirë shoqëror përfshinë ndjenjën e identitetit dhe përkatësisë së tij me komunitetin ku jeton, barazinë e individit në edukim, punësim e drejtësi, ndjenja ndaj familjes dhe rrethit ku jeton, si dhe lidhja me vendin e tij në mes tjerash. Kohezioni shoqëror dhe identiteti përbëjnë faktorët kyç që kanë ndihmuar Kosovën në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm si dhe mund të kontribuojnë në parandalimin e fenomeneve të ngjashme në vend në të ardhmen. Përkatësia e fortë etnike e identitare pa dyshim se përbënë një element esencial të reziliencës sidomos në rast se ajo synohet të sfidohet nga mësymjet ideologjike nga jashtë, të cilat janë të mbuluara me petkun identitar që nuk përkon me atë tradicional në Kosovë. Matjet e bëra me këtë raport tregojnë një nivel të lartë të harmoni dhe tolerancë që kanë qytetarët e Kosovës dhe komunitetet ndaj invididëve të cilët i takojnë besimit, etnisë apo racës tjetër. Të dhënat tona tregojnë që qytetarët e Kosovës kanë arritur një maturitet të lartë dhe janë të qëndrueshëm ndaj fenomeneve të panjohura si ekstremizmi i dhunshëm. Mirëpo, një përbindje solide e qytetarëve të vendit, ende mbeten të rezervuar për të *pranuar apo bashkëjetuar me individë që kanë orientim të ndryshëm politik, religjioz apo etnik.*

Të dhënat tregojnë se ndikimet nga komuniteti, prejardhja dhe lidhjet familjare, shoqëria e ngushtë kanë qenë disa ndër faktorët kryesor në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në të kaluarën.²⁰ Pikërisht duke marrë parasysh këto të dhëna ne jemi munduar të vlerësojmë rëndësinë që ka komuniteti dhe familja në ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme kundër dhunës dhe konfliktit në Kosovë.²¹

20 Shpend Kursani "Extremism Research Forum- Western Balkans" Kosovo report, 2018 https://kosovo.britishcouncil.org/sites/default/files/erf_report_kosovo_2018.pdf

21 Skender Perteshi "Përtej shkaktarëve: Rreziqet e reja të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë" QKSS, Prishtine 2018

1.1 NDJENJA NDAJ KOMUNITETIT

QKSS ka bërë matjen e opinionit publik në Kosova lidhur me kohezionin shoqëror dhe çështjen e identitetit në Kosovë. Qytetarët janë pyetur se sa ndjehen të rëndësishëm dhe se deri në ç’masë e identifikojnë vetën me komunitetin në të cilin jetojnë. Bazuar në opinionin e qytetarëve, 52 % e të anketuarve deklaruan se janë të rëndësishëm për komunitetin dhe e ndiejnë vetën pjesë të komunitetit të tyre, ndërsa 25 % e qytetarëve të intervistuar kanë thënë se deri në një masë e ndiejnë vetën të rëndësishëm për komunitetin e tyre.²² Pjesa tjetër apo 16 % e të respondentëve nuk patën përgjigje rreth kësaj pyetje, kurse 6 % e të anketuarve tjerë treguan se nuk e ndiejnë vetën pjesë të komunitetit, dhe se komuniteti nuk i përfaqëson ata si dhe interesat e tyre.²³




Figura 1-Sa e ndjeni veten të rëndësishëm në komunitetin ku jetoni

²² Barometri Kosovar i Sigurisë 2019

²³ Ibid:

Është shumë e rëndësishme që individët të cilët jetojnë brenda komunitetit të ndihen pjesë e tij dhe të mos jenë të diskriminuar ata ose familjet e tyre. Në pyetjen e bërë respondentëve se a e identifikoni veten me komunitetin në të cilin jetoni, rreth 88 % e respondentëve treguan se identifikojnë vetën me komunitetin në të cilin jetojnë, ndërsa 8 % e të intervistuarve treguan që deri në një masë e identifikojnë vetën me komunitetin të cilit i takojnë. Një pakicë e vogël apo rreth 3 % treguan se nuk e shohin vetën pjesë të komunitetit në të cilin jetojnë si dhe nuk ndiejnë vetën të afërt me vlerat e komunitetit të tyre. Sipas tyre këta janë të harruar dhe marginalizuar nga komuniteti dhe ndihen të stigmatizuar nga ana e tyre.²⁴ Kjo tregon që ekziston një kohezion shoqëror lidhur me përkatësinë identitare e cila vështirë se mund të sfidohet substancialisht nga faktorët ndikues të jashtëm, dhe e bënë të qëndrueshëm komunitetin kundër të gjitha formave të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.




Figura 2- Shkalla e diskriminimit të individit apo familjes nga ana e komunitetit

24 Barometri Kosovar i Sigurisë 2019.

1.2 STIGMA DHE DISKRIMINIMI

Stigma dhe diskriminimi janë ndër faktorët kyç që shpiejnë në radikalizimin e individit apo komunitetit. Në të kaluarën kemi hasur në raste të shpeshta kur komuniteti ka qenë diskriminues dhe i ka izoluar familjet dhe individët për shkak të mënyrës së praktikimit të fesë.

Në pyetjen drejtuar respondentëve se a pajtoheni që ju apo familja juaj, jeni diskriminuar nga komuniteti në 18 muajt e fundit: rreth 88 % e tyre u deklaruan se asnjëherë ata apo familja e tyre nuk janë ndier të diskriminuar nga ana e komunitetit dhe janë shumë të lidhur me komunitetin. Pjesa tjetër apo 12 % e respondentëve u shprehën se janë ndier pjesërisht të diskriminuar nga komuniteti.²⁵ Është shqetësuese numri i individëve (12 %) të cilët deklaruan se janë të diskriminuar nga ana e komunitetit. Edhe pse arsyet e kësaj ndjesie nuk dihen dhe mbase përqindja e tillë sado e vogël është fluide, mund të vlerësohet se kategoria e tillë mund të jetë cak i dëshirueshëm i ndikimeve ideologjike nga jashtë të cilat në realitet janë pjesë e formacioneve radikale e ekstremiste, religjioz apo etnike.




Figura 3-Shkalla e diskriminimit të së invididit apo familjes nga ana e komunitetit

²⁵ Të dhëna të mbledhura nga organizimi i fokus grupi në Mitrovicë. Mitrovicë, Shkurt 2019.

Në anën tjetër, përderisa individët kanë një lidhje shumë të fortë me komunitetin e tyre qytetarët kanë pikëpamje tjera sa i përket diskriminimit të komunitetit të tyre nga ana e institucioneve shtetërore të nivelit qendror dhe lokal. Qytetarët shprehën shqetësimet e tyre sa i përket prezencës së shtetit në komunitet sidomos me investimet publike prej anës së tyre.²⁶ Sipas respondentëve, Qeveria e Kosovës dhe deputët e Kuvendit të Kosovës vizitojnë komunitetin vetëm në kohë zgjedhjesh apo kur kanë ndonjë arsye për përfitim politik, dhe jo për të kuptuar rreth shqetësimeve me të cilat përballet komuniteti apo gjetjen e mënyrave për adresimin e tyre. Mungesa e bashkëpunimit dhe e komunikimit të elitave politike me komunitetet e cenueshme në Kosovë zgjeron potencialin rekrutues për organizatat ekstremiste apo individ të ndryshëm duke rritur kështu ndikimin e tyre në komunitet. Këtu nuk duhet përfshirë as organizatat që si qëllim parësor kanë futjen e elementëve radikal fetar apo etnik në komunitet siç ka ndodhur pas luftës së vitit 1999 në Kosovë.²⁷

Si rikujtim kontekstual, pas luftës në Kosovë, organizatat të ndryshme humanitare me origjinë nga vendet e Gjirit Persik, kanë qenë shume aktive duke përhapur elemente të ekstremizmit islamist në komunitet. Këto e kanë bërë duke shfrytëzuar nivelin e lartë të varfërisë në nivel komuniteti si dhe mungesën e prezencës së “dorës së shtetit” tek këto komunitete. Ende vërehen elemente të tilla në komunat dhe rajonet ku jetojnë minoritetet si në Veriun e Kosovës, dhe disa komuna të Kosovës, të komunitetit Goran, Romë, Ashkali dhe Egjiptian.²⁸ Të gjitha këto ndikime ideologjike e politike nga jashtë janë bërë në dëm të një kohezioni mjaft të konsoliduar shoqëror e identitar në Kosovë, duke u munduar të prishin tolerancën etnike dhe fetare në vend.

Në pyetjen se **A mendoni që ju dhe komuniteti juaj jeni të diskriminuar apo harruar nga Qeveria e Kosovës**, shumica e repondentëve apo 56 % e të anketuarve u shprehën se Qeveria e Kosovës është shumë pak prezente në komunitetin tonë dhe se komuniteti i tyre ka një ndërveprim shumë të vogël me Qeverinë e Kosovës. Pjesa tjetër apo rreth 30 % e respondentëve u shprehën deri në një masë Qeveria e Kosovës është prezente në komunitetin të cilit i takon. Pjesa tjetër apo 11 % e të intervistuarve deklaruan se janë të kënaqur me punën e Qeverisë së Kosovës dhe se qeveria është prezente në komunitetin e tyre.²⁹

26 Të dhëna të mbledhura nga Grupet e Fokusit në Prishtinë dhe Prizren. Shtator 2019, dhe Nentor 2019.

27 Ibid:

28 Obzervim nga ana e hulumtuesve të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë si dhe të dhëna nga institucionet kosovare të zbatimit të ligjit.

29 Barometri Kosovar i Sigurisë 2019




Figura 4- Shkalla e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit dhe institucioneve shtetërore

Kjo tregon se sa më pak ndërveprim e ndër komunikim me qytetarët aq më shumë potencial për shtrirje të ideologjive të jashtme ekstreme ne nivel komuniteti.

QKSS poashtu ka parashtruar pyetjen se mendoni që ju dhe komuniteti juaj jeni të diskriminuar apo harruar nga institucionet lokale? Sipas respondentëve, krahasuar me nivelin qëndror, niveli lokal është më shumë prezent në komunitet. Nga totali i respondentëve të anketuar, 47 % e tyre treguan që institucionet lokale janë pak prezente në komunitet, dhe komuniteti ndihet i harruar nga ana e institucioneve lokale. Pjesa tjetër e respondentëve apo 33%³⁰ e tyre u shprehën se institucionet lokale deri në një masë janë prezente në komunitetin tonë, kurse rreth 18 % u shprehën se janë të kënaqur me prezencën dhe punën e institucioneve lokale në komunitet.

30 Ibid:



Figura 5-Shkalla e diskriminimit të komunitetit nga ana e institucioneve shtetërore

Të dhënat tregojnë se individët janë shumë të lidhur me komunitetin dhe se nuk vërehen elemente të mëdha të stigmës në nivel komunitar. Shqetësuese është mungesa e një bashkëpunimi dhe ndërveprimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe komunitetit. Një mungesë e tillë është një pikë e dobët dhe e bënë komunitetin më të cenueshëm ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, pasi që mungesën e bashkëpunimit të institucioneve me komunitetin e shfrytëzojnë organizata apo individë të ndryshëm që kanë për qëllim të përhapjes së elementeve radikale religjioze apo etnike.

1.3 FUQIA E FAMILJES SI INSTRUMENT I REZILIENCËS SHOQËRORE

Familja ka ndikim shumë të madh në krijimin e komuniteteve të qëndrueshme kundër dhunës dhe ekstremizmit në Kosovë. Problemi ndërmjet gjeneratave brenda anëtarëve të familjes dhe dallimet ndërmjet tyre në tema si feja, shtet-ndërtimi dhe orientimet seksuale mbesin mjaft të theksuara, gjë që përbënë një dukuri të pranishme në çdo shoqëri post-tranzicionale.³¹

Rreth rrolit të familjes në procesin e radikalizmit apo përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm tregojnë edhe hulumtimet e kryera nga QKSS (2016 dhe 2018) dhe British Council (2018) ku janë analizuar lidhjet familjare të mbi 90 qytetarëve Kosovar pjesëmarrës në luftërat në Siri dhe Irak. Nga mbi 90 individët e përzgjedhur që kanë udhëtuar për në Siri / Irak, hulumti-

31 QKSS "Shkaktarët e Përfshirjes së qytetarëve të Kosovës në luftërat e huaja në mënyrë të pa autorizuar. Prishtina, Pril 2015

met kanë gjetur se shumica e tyre kishin lidhje familjare apo njiheshin ndërmjet vete. Një numër i madh i këtyre 90 rasteve ishin motra dhe vëllezër ose burrë e grua.³² Kjo tregon që nëse brenda familjes ka elemente radikale atëherë shumë lehtë ajo mund të përcillet edhe tek anëtarët e tjerë të familjes, varësisht nga niveli ndikues i të rekrutuarit të parë. Në anën tjetër, kontributi familjar ka qenë shumë i rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm sidomos prej vitit 2012.³³ Është dëshmuar që familja ka qenë dhe duhet të jetë shtylla kryesore në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe atë të krijimit të komuniteteve rezistuese ndaj këtij fenomeni.

Përplasjet brenda anëtarëve të familjes apo dhuna në familje ishte prezente tek familjet të cilat ishin prekur nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi në Kosovë. Prej 250 luftetarëve të cilët kanë udhëtuar në Siri dhe Irak, mbi 40 % e këtyre rasteve janë përballur me vepra të ndryshme penale duke përfshirë edhe dhunën në familje. Në shumicën e rasteve kur njëri apo disa anëtar të familjes kanë shpërfaqur ide ndryshe rreth Islamit apo mënyrës së praktikimit të tij, të cilat janë konsideruar si ndër shenjat e hershme të radikalizmit, ai-ajo është sulmuar nga prindi i tij apo anëtarët e tjerë të familjes,³⁴ për shkak të mënyrës së praktikimit të fesë. Kjo qasje ka ndikuar në izolimin e këtyre të fundit, dhe madje e ka lehtësuar procesin e radikalizimit të tyre.³⁵ Pra në këto raste familja nuk ka shërbyer si mekanizëm mbrojtës për anëtarët e radikalizuar të familjes, por më shumë një lloj 'lehtësuesi' mbase i pavetëdijshëm i procesit të radikalizimit të tyre duke kontribuar në stigmën dhe izolimin e tyre.³⁶

Reagimet e tilla familjare sado që nuk janë komunikuar mirë kanë qenë tregues i një kohezioni identitar etnik e shoqëror tek familjet kosovare të cilat kanë kundërshtuar elemente radikale e ekstreme të cilat nuk kanë qenë më herët të pranishme në vend. Mirëpo, në mungesë të njohurive adekuate për tu përballur më anëtarët e familjes të cilët kanë shfaqur shenjat e hershme të radikalizmit dhe presioni që u është bërë këtyre të fundit ka ndikuar në rritjen tutje të radikalizmit dhe ekstremizmit brenda anëtarëve të familjes, edhe psë qëllimi ka qenë luftimi i sjelljeve të tilla.

32 British Council report on https://kosovo.britishcouncil.org/sites/default/files/erf_report_kosovo_2018.pdf

33 Skender Perteshi "Përtej shkaktarëve: Rreziqet e reja të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë" QKSS, Prishtine 2018

34 Interviste me N.D familjar i nje luftetari te huaj I cili ka udhetuar ne Siri. Dhjetor 2019

35 Të dhëna të kalkuluara nga databaza e institucioneve shtetërore të zbatimit të ligjit, si dhe nga databazat e përgaditura nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

36 Skender Perteshi "Përtej shkaktarëve: Rreziqet e reja të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë" QKSS, Prishtine 2018

Me fjalë të tjera, familja, ndjenja fetare dhe ajo kombëtare janë shumë rëndësishme në zhvillimin e personalitetit të individit në Kosovë. Nëpërmjet anketës së BKS 2019 respondentët janë pyetur se cili prej identiteteve si: familjar, kombëtar, fetar, profesional apo politik kanë ndikuar më së shumti në formimin tuaj personal.³⁷ 60 % e të anketuarve deklaruan se familja ka ndikuar më së shumti në formimin e tyre personal. Kurse aspekti kombëtar, politik apo fetar kanë pasur rol pothuajse të ngjashëm në zhvillimin e tyre personal. Pra sipas të anketuarve familja ka pasur dhe ende ka rolin kryesor në formimin e tyre personal, si dhe edhe nëse kanë ndonjë shqetësim sërish familja mbetet autoriteti kryesor për adresimin e tyre.




Figura 6-Cilat prej identiteteve ka ndikuar më së shumti në zhvillimin e personalitetit tënd

Përkundër sfidave të përmendura më lartë, qytetarët e Kosovës ende e shohin familjen si adresën kryesore ku ata mund ti adresojnë shqetësimet e tyre dhe presin mbështetje për ti zgjidhur ato.

Në pyetjen e bërë respondentëve se në rast se keni ndonjë pakënaqësi apo shqetësim ku drejtoheni për të kërkuar ndihme: 73 % e respondentëve u shprehën se familja është adresa kryesore ku ata kërkojnë mbështetje për problemet dhe shqetësimet e tyre. Pas familjes, 18 % e respondentëve deklaruan se institucionet e shtetit ishin adresa kryesore ku ata kërkojnë zgjidhje për shqetësimet e tyre, ndërsa pjesa tjetër apo 9 % e të anketuarve mendojnë që shokët

³⁷ Ibid.

apo institucionet fetare janë adresa ku ata mund të kërkojnë mbështetje për adresimin e ndonjë shqetësimi të cilin ata mund ta kenë.³⁸




Figura 7- Në rast se keni ndonjë shqetësim të sigurisë, ku kërkon mbështetje

Kjo tregon se në mungesë të një shteti të konsoliduar, familja vazhdon të mbretëroj si një instrument i rëndësishëm i reziliencës shoqërore në raste kur identiteti etnik e shoqëror sfidohet nga manifestimet e ndryshme ideologjike nga jashtë.

Familja ende mbetet mekanizmi kryesor ku individët besojnë dhe e shohin si mundësi për zgjidhjen e shqetësimeve të tyre. Dallimet ndërmjet gjeneratave për tema si feja dhe mënyrën e praktikimit të tij, krijimin e mundësive e barabarta gjinore, orientimi seksual apo tema tjera shpesh kanë qenë burim konflikti brenda familjes. Ende ka mungesë të tolerancës brenda anëtarëve të familjes, kur kemi të bëjmë me rastet kur anëtarët e familjes fillojnë së praktikuari religjionin në mënyrë më strikte. Mungesa e njohurive se si duhet të sillemi me anëtarët e familjes të cilët janë në fazën e hershme të radikalizmit, është pikë e dobët brenda komunitetit dhe familjeve në Kosovë duke i bërë individët më cenueshëm ndaj rekrutimeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

1.4 TOLERANCA NDAJ ETNISË TJETËR

Një element shumë i rëndësishëm i kohezionit shoqëror dhe që ndihmon në krijimin e komuniteteve rezistente ndaj ekstremizmit të dhunshëm është harmonia e mirë ndërmjet individëve të etnisë, besimit, racës apo orientimit politik tjetër. Kjo vlen sidomos në rastin e Kosovës dhe Rajonit e Ballkanit, për shkak se në të kaluarën jemi përballur me konflikte të mëdha ndëretnike dhe si rezultat i të cilave vlerësohet se janë vrarë ndërmjet 100 mijë deri 150 mijë viktime civile në gjithë rajonin. Rajoni ynë ende është duke u përballur me pasojat e atyre konflikteve të ndodhura duke filluar me konfliktin në Bosnje dhe Hercegovina e Kroaci në vitin 1992, duke vazhduar me Kosovën deri në 1999, e duke përfunduar me konfliktin në Maqedonisë së Veriut në vitin 2001.

Për më shumë, vazhdimi i kontestit politik e historik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vijon së ushqyeri narrativen e urrejtjes dhe jo-tolerance ndëretnike të cilat po i mbajnë gjallë kujtimet e konfliktit ndëretnik në jetën e qytetarit në të dyja vendet. Në pyetjen se a “A jeni te gatshëm të pranoni në komunitetin tuaj ndonjë individ që i takon etnisë tjetër” shumica e qytetarëve apo 64 % e tyre treguan se janë të gatshëm të pranojnë dhe të jetojnë me një individ që i takon etnisë tjetër në Kosovë ndërsa 10 % e të anketuarve treguan se deri në një masë janë të gatshëm që ti pranojnë individët të cilët i takojnë etnisë tjetër.

Shqetësuese mbetet fakti se një numër i konsiderueshëm i të anketuarve u treguan të rezervuar rreth pranimin apo jo të individëve që u përkasin etnisë tjetër. Rreth 25 % e të anketuarve u shprehën se nuk do të praninin të jetonin bashkë me një individ që i takon etnisë tjetër. Numri prej 25 % e atyre që refuzojnë punën dhe jetën me individët që i përkasin etnisë tjetër është shumë shqetësues dhe shërben si burim për përplasje ndëretnike në Kosovë apo të shërbejë si burim i destabilitetit në vend e rajon.³⁹

39 Barometri Kosovar i Sigurisë 2019




Figura 8- Shkalla e tolerancës ndaj individit të etnisë tjetër

Mosdurimi ndaj etnisë tjetër shërben si potencial për përplasje të dhunshme ndërmjet etnive të ndryshme që jetojnë në Kosovë. Mosdurimi ndaj komuniteteve të cilat i takojnë etnisë tjetër e rritë ekstremizmin nacionalist i cili mund të jetë burim për përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm me baza etnike. Nacionalizmi i tepruar mund të kalojë në ekstremizëm të dhunshëm i cili ndikon në përhapjen e formave tjera të ekstremizmit duke përfshirë atë religjioz.

1.5 TOLERANCA NDAJ RACËS TJETËR

Toleranca e lartë ndaj individit që i takon racës tjetër është një tregues që një shoqëri është e hapur dhe e qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Ekzistojnë shumë shembuj në botë ku për shkak të racës kanë ndodhur konflikte të ndryshme në botë të cilat kanë rezultuar me miliona të vrarë. Jetesa me individ apo komunitete që u takojnë racës tjetër ende mbetet çështje pak e njohur për Kosovën, duke qenë se vendi ynë nuk është një vend ku individ të kombeve e racave të ndryshme migrojnë për një jetë më të mirë.

Përkundër mundësisë së vogël të kosovareve për të bashkëjetuar me individ që i takojnë racave tjera, komuniteti në Kosovë është treguar mesatarisht i hapur për pranimin e individëve të racave të tjera. Në pyetjen se a jeni të gatshëm të pranoni në komunitetin tuaj ndonjë individ që i takon racës tjetër, mbi 60 % e të anketuarve treguan se janë të gatshëm të pranojnë në komunitetin e tyre individ të racës tjetër, ndërsa 30 % e të anketuarve tjerë ishin kundër pranimin të tyre. Pjesa tjetër apo 8 % e të anketuarve ishin të rezervuar për tu përgjigjur në këtë pyetje.⁴⁰




Figura 9-Shkalla e tolerancës ndaj etnisë tjetër

Ky është indikator që një përqindje respektabile e popullatës nuk është ende e gatshme të jetë tolerante dhe të bashkë-jetoj me persona të racave tjera, duke aluduar këtu në ato që vijnë nga vendet jo-Evropiane. Të dhënat nuk janë tregues i mirë se si do të reagoonte komuniteti në Kosovë në rast se do të kishte mundësinë që të bashkëjetonin me individ të racës tjetër në komunitetin e tyre.

40 Barometri Kosovar i Sigurisë 2019.

1.6 TOLERANCA FETARE

Sikurse toleranca racore, edhe ajo fetare janë shumë të rëndësishme në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në vend. Bashkëjetesa brenda feve kontribuon në reduktimin e potencialit për dhunë brenda komuniteteve që u përkasin besimeve të ndryshme fetare apo sekteve të veçanta brenda tyre. Viteve të fundit jemi dëshmitar të konflikteve të mëdha në Lindjen e Mesme dhe Afrikë si pasojë e mos durimit fetar, konflikte prej të cilave është prekur edhe Kosova. Si rezultat i konflikteve për kauza të ashtuquajtura fetare në Siri dhe Irak, rreth 100 qytetar të Kosovës kanë humbur jetën duke luftuar përkrahë organizatave të ndryshme paraushtarake.⁴¹




Figura 10-Shkalla tolerancës ndaj komunitetit apo individit që i takon religjionit tjetër

41 Të dhënat zyrtare të institucioneve të zbatimit të ligjit në Kosovë si dhe të dhënat e mblledhura në databazat e Qendres Kosovare për Studime të Sigurisë.

Kosova shquhet për bashkëjetesë ndërmjet komuniteteve të besimeve të ndryshme të cilët kanë jetuar dhe vepruar në këto troje. Të dhënat e BKS 2019 tregojnë për një bashkëjetesë të madhe fetare në Kosovë. Në pyetjen se a jeni te gatshëm të pranoni në komunitetin tuaj ndonjë individ që i takon besimit tjetër, 73 % e respondentëve u shprehën se janë plotësisht të gatshëm që të pranojnë në komunitetin e tyre individ që i takon besimit tjetër, ndërsa 19 % e të anketuarve tjerë u shprehën se nuk do të praninin në komunitetin e tyre ndonjë individ apo komunitet që i takon besimit tjetër. Pjesa tjetër apo rreth 8 % e tyre u shprehen se deri në një masë janë të gatshëm që të pranojnë në komunitetin e tyre individ që i takon besimit tjetër.⁴²

Përkundër përçindjes së lartë të respondentëve që u shprehën të gatshëm që të pranojnë individ që i takon besimit tjetër fetar, shqetësues mbetet fakti tek përçindja e atyre që refuzuan të praninin në komunitetin e tyre individë që i takojnë besimit tjetër. Shifra 19 % e atyre që refuzojnë të bashëpunojnë apo të pranojnë individin i cili i takon besimit tjetër, krijon një hapësirë të madhe apo potencial për dhunë dhe mos-durim fetar në vend. Kësaj shtate i kanë kontribuar shumë klerikët fetar prej të gjitha religjioneve në Kosovë. Vlenë të theksohet fakti se Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) ka qenë e ngathët në promovimin e diversitetit brenda-fetar por edhe në tolerancën ndaj feve tjera. Në anën tjetër, Kisha Ortodokse Serbe ka vijuar të jetë promovuese e nacionalizmit ekstremist serb përderisa narracioni i disa prijësve të saj ka ngërthyer motive politike nganjëherë të urretjes në dëm të popujve tjerë, sidomos shumicës shqiptare. Në rrjetet sociale ende mund të hasësh mesazhe të klerit fetar të cilët promovonë urretje fetare, racore, kombëtare e gjinore dhe kontribuojnë në mos pranimin e tjerëve të cilët besojnë ndryshe.

Në përgjithësi shoqëria Kosovare mbetet tolerante ndaj individëve apo komuniteteve që i takojnë racës, etnisë apo besimit tjetër. Shumica e të anketuarve deklaruan se janë të gatshëm të bashkëjetojnë me komunitete dhe individ të etnive dhe religjioneve të ndryshme. Një përçindje solide (afro 20 %) e të intervistuarve deklaruan se nuk do të bashkëjetojnë me individ që i takonin racës, etnisë apo besimit tjetër. Kjo përçindje mund të shërbej si burim potencial i konfliktit ndërmjet komuniteteve në Kosovë. Një qasje e tillë mund të ndikoj që komuniteti që është minoritet dhe që i takon religjionit tjetër të jetë më i cenusur ndaj dhunës ekstremizmit apo radikalizmit në vend. BIK, Kisha Ortodokse si dhe akter tjerë në vend duhet të fillojnë me promovimin e komunitetit drejt

42 Barometri Kosovar i Sigurisë 2019.

bashkëjetesës ndëretnike dhe fetare në Kosovë, me qëllim të krijimit të komuniteteve rezistuese ndaj dhunës e radikalizmit në vend.

1.7 IDENTITETI DHE REZILIENCA

Kriza e identitetit, përhuajësimi, pabarazia si dhe ndjenja e përkatësisë kanë qenë ndër faktorët kryesor të cilët kanë ndikuar që mijëra individ nga vendet e Bashkimit Evropain e me gjerë tu bashkohen organizatave terroriste në Siri dhe Irak.⁴³

Për krijimin e komuniteteve reziliente ndaj dhunës dhe radikalizmit duhet të krijohet një ambient i lirë ku qytetarët mund të shprehin lirisht orientimet apo ndjenjat e tyre fetare, kombëtare e politike. Stigma në shprehjen e identitetit të tij-saj fetar, politik apo religjioz krijon hapësirë për vet-izolim, padrejtësi e përhuajësim të cilat krijojnë individ dhe komunitete të cënueshme prej ekstremizmit dhe radikalimit. Liria e shprehjes së orientimit fetar ose politik ndihmon në krijimin e komuniteteve reziliente në vend.⁴⁴

Identiteti kombëtar vijon të jetë shumë i theksuar tek shqiptaret e Kosovës. Në pyetjen se për cilën pjesë të identitetit ndiheni më krenar ta ndajnë me komunitetin tuaj. 55 % e repodentëve deklaruan se ndjehen shumë krenar që me komunitetin të ndajnë identitetin kombëtar i pasuar 18 % të tyre që ndihen krenar me identitetin e tyre fetar si dhe 16 % e atyre që ndihen krenar të ndajnë me komunitetin e tyre identitetin e tyre qytetar apo origjinën nga vijnë. Ky është një faktor i reziliencës shoqërore për arsyeje se mbizotërimi i përkatësisë etnike e kombëtare është antidot i ndikimeve ideologjike nga jashtë të cilat manifestohen në forma të modifikimit apo ndryshimit të identitetit organik.

43 Oliver Roy "Globalized Islam- The search for a neë Ummah" Columbia University Press 2006

44 Të dhëna nga fokus grupet në Prishtinë (Nentor 2019), Mitrovicë (Shtator 2019) dhe Prizren




Figura 11- Për cilën pjesë të identitetit ndihen më krenar në komunitetin tuaj

Më herët nëpërmjet anketimit qytetarët patën mundësi të deklarohen se cilin prej përcaktimeve të tyre ndihen më krenar të ndajnë me komunitetin e tyre, kurse në këtë pjesë të raportit qytetarët kanë mundësinë që të shprehen se cilët nga përcaktimet apo orientimet e tyre janë mëse paku të lirë ta ndajnë me komunitetin e tyre.




Figura 12-Ciin prej identitetit apo përcaktimit tuaj hezitoni ta ndani me komunitetin tuaj

Nga 55 % e respondentëve të anketuar u shprehën se përcaktimin apo orientimin e tyre politik do të ishin më së paku të lirë të shprehnin me komunitetin e tyre. Sipas tyre shprehja e lirë e orientimit apo bindjes politike në Kosovë mund të jetë e kërcënim i madh për vendin e punës apo edhe je mundesh të jesh më pak i pranuar nga komuniteti ku jeton. Pas identitetit apo orientimit politik, qytetarët u shprehën më pak të lirë të shprehin identitetin apo ndjenjën e

tyre fetare me komunitetin e tyre. 16 % e të anketuarve treguan se ambienti në Kosovë si dhe komuniteti ku jetojmë nuk ofron siguri dhe liri të mjaftueshme për praktikimin e lirive fetare, edhe pse ato janë të garantuara me Kushtetutë. Sipas këtyre anketuesve nëse je praktikues më konservator fetar në Kosovë je i diskriminuar dhe stigmatizuar në komunitetin ku jeton dhe në vendin e punës.⁴⁵

Sipas tyre “në momentin që kuptohet që ne jemi praktikues më konservator të islamit, është shumë më e vështirë që ne të pranohemi në punë qoftë në sektorin publik apo privat”. Për më shumë dhe “më e vështirë është punësimi i grave ne sektorin publik e privat nëse ato janë praktikuese e religjionit”.⁴⁶ Komunitetet në Kosovë si dhe institucionet e shtetit duhet të jenë më të hapura në krijimin e një ambienti të sigurtë dhe të lirë ku të gjithë qytetarët pa marrë parasysh besimin që i takojnë apo mënyrën se si e praktikojnë besimin e tyre dhe të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Aspekti kombëtar mbetet përcaktues i identitetit shqiptareve të Kosovës, si dhe komunitetit në të cilin ata jetojnë. Qytetarët e Kosovës ndihen jashtëzakonisht krenar me identitetin e tyre kombëtar. Përderisa individët janë ndjerë të lirë të shprehin me komunitetin e tyre identitetin e tyre kombëtar, të dhënat tregojnë se një përqindje jo e vogël nuk janë shprehur të lirë që të ndajnë me komunitetin e tyre orientimin e tyre politik apo bindjet e tyre fetare. Ambienti në Kosovë ende nuk arritur që të krijoj hapësirë të lirë për të shprehur lirshëm identitetin fetar apo orientimin politik. Mungesa e lirisë për shprehjen e orientimit politik e fetar në Kosovë, është një ndër pikat e dobëta e të cenueshme në Kosovë, të cilat mund të jenë burim e potencial për përhapjen e dhunës dhe radikalizmit në Kosovë.

45 BKS2019

46 Të dhëna na organizimi i Grupit të Fokusit në Prishtinë, Shtator 2019.

2. BESIMI NË SHTET DHE LIDHJA ME KOSOVËN

2.1 BESIMI NË SHTET DHE MIGRIMI

Besueshmëria e qytetareve të Kosovës me shërbimet që ofrohen nga institucione e shtetit është shumë e ulët. Qytetarët për vite me radhë kanë shprehur pakënaqësitë ndaj institucioneve të Kosovës për shkak të përhapjes së madhe të korrupsionit dhe krimit të organizuar në institucionet e shtetit. Pra, sipas respondentëve, institucionet e shtetit punojnë më shumë për favore dhe interesa ndaj grupeve të tyre të interesit se sa për interesin e përgjithshëm publik.⁴⁷ Insitucionet e dobëta shtetërore, kapja e shtetit si dhe humbja e shpresës për një jetë më të mirë, krijuan një ambient të përshtatshëm për përhapjen e elementeve radikale dhe të ekstremizmit të dhunshëm në vend.

Roli i Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera të shtetit është esencial në parandalimin e dhunës dhe konfliktit tek komunitetet në Kosovë si dhe të krijoj një ambient ku qytetarët mund të ndjehen të sigurtë dhe të barabartë në vend. Një ambient i tillë në Kosovë nuk është krijuar për më shumë se dy dekada, dhe kjo ka ndikuar që prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës (17 Shkurt 2008) mbi 450.000 mijë qytetar të Kosovës të largohen nga vendi drejt shteteve në Bashkimit Evropian.⁴⁸ I vetmi sektor i cili gëzon mbështetje të madhe dhe besim nga ana e qytetareve të Kosovës është sektori i sigurisë si: Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Policia e Kosovës (PK).⁴⁹

Në anketën e bërë nga UNDP në vitet 2018, 2019 dhe vitin 2020 për besimin e qytetarëve ndaj Qeverisë së Kosovës vërehen ndryshime të mëdha. Viti 2018 dhe viti 2019 tregojnë që qytetarët kishin një besim shumë të ulët ndaj Qeverisë së Kosovës e cila udhëhiqej nga Ramush Haradinaj. Në vitin 2018 besueshmëria ndaj Qeverisë ishte vetëm 30 për qind, kurse në vitin 2019

47 Të dhëna të mbledhura nga Grupet e Fokusit të mbajtura në Prishtinë (Shtator 2019), Mitrovicë (Tetor 2019) dhe Prizren (Shtator 2019).

48 Ibid.

49 Barometri Kosovar i Sigurisë 2019.

pati rënie të besueshmërisë në 17 përqind e qytetarëve të cilët i besonin Qeverisë së Kosovës. Viti 2020 ishte viti i cili pati ngritje shumë të madhe të besueshmërisë së qytetarëve ndaj Qeverisë së Kosovës. Në anketën e kryer nga UNDP në Prill të vitit 2020, qytetarët shprehën mendimin e tyre lidhur me besueshmërinë ndaj Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit. Prej respondentëve të anketuar 60.70 %⁵⁰ e të anketuarve treguan se kanë besim të plotë dhe janë të kënaqur me punën e Qeverisë së Kosovës e udhëhequr nga z. Kurti. Një shkallë kaq e lartë e besueshmërisë së Kosovës ndaj Qeverisë së Kosovës ishte shpresë për një ve bashkëpunim më të mirë ndërmjet qytetarëve dhe Qeverisë së Kosovës, e cila do të ndihmonte edhe në ngritjen e reziliencës së komunitetit ndaj formave të ndryshme të ekstremizmit.




Figura 13- Besueshmëria e qytetarëve ndaj Qeverisë së Kosovës

Deri në këtë kohë qytetarët e Kosovës nuk i besonin aspak Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve tjera shtetërore sepse ato shiheshin si burim i korrupsionit, dhe kishte pak shpresë se këto institucione mund të përmirësonin jetën e qytetarit. Kjo besueshmëri e madhe e qytetarëve ndaj Qeverisë së Kosovës u shua kur në Mars të vitit 2020, Qeveria e Kosovës u rrë-

50 Raporti i pulsit publik të UNDP për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

zua pas mocionit të suksesshëm të mos besimit të iniciuara nga LDK, e të votuara nga partitë të cilat kanë qeverisur me Kosovën për më shumë se 20 vjet.

Kapja e shtetit, korrupsioni dhe krimi i organizuar i përhapur në institucionet e vendit për afro dy dekada kanë ndikuar një besueshmëri të ulët të qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë dhe atyre qeverisëse në vend. Për përhapjen e korrupsionit në sektorin publik çdo vit shkruajnë edhe organizata të rëndësishme ndërkombëtare të cilat mbështetin Kosovën në zhvillimin e saj. Komisioni Evropian në raportin e tij në vitin 2019 e vlerëson se Kosova është ende në hapat e hershëm të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit në sektorin publik. Ky raport i vlerëson institucionet drejtësisë së vendit si të paafta për të luftuar krimin e korrupsionin. Sipas tyre korrupsioni është shumë i përhapur në sektorin publik.⁵¹ Poashtu ky raport thekson si shqetësues faktin për influencimin e politikës në procesin e rekrutimit të stafit civil në sektorin publik⁵² ku nuk garantohet proces i drejtë dhe transparent në procesin e rekrutimit të stafit civil në sektorin publik.

Poashtu, edhe raporti i Transparency International, Kosovën e rendit shumë poshtë për mosefikasitet në luftën kundër korrupsionit duke e vlerësuar si një vend që ka bërë pak progres në luftën kundër korrupsionit. Nga 180 vende në të cilat është krahasuar niveli i përhapjes së korrupsionit, Kosova renditet numër 93, me 37 pikë të shënuara në këtë indeks, dhe është në të njëjtin grup me vendet si Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Gambia e Mongolia sa i përket rezultateve në luftën kundër korrupsionit në sektorin publik.⁵³

Qytetarët kanë qenë të pakënaqur me punën dhe shërbimet e institucioneve të shtetit si Qeveria, Kuvendi, komunitatet e sektori i drejtësisë. Qytetarët shumë pak i besojnë institucioneve të shtetit dhe janë të zhgënjyer me punën e tyre. Sipas respondentëve shteti i Kosovës është i kapur nga politika dhe grupet tjera të interesit dhe të cilët nuk punojnë në të mirën e përgjithshme. Vendet të cilat përballen me sfida si: kapja e shtetit, institucionet e dobëta shtetërore dhe besimi i vogël i qytetarëve në institucionet e shtetit janë të përshtatshme për përhapjen e ideologjive ekstremiste dhe radikale nga shtete apo organizata të ndryshme. Pakënaqësitë e mëdha të qytetarëve të krijuara si pasojë e keq-qeverisjes në vend, përbëjnë potencial të madh për dhunë, dhe do të shfrytëzohen nga grupet e ndryshme për përhapje elemente radikale.

51 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2019. <https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

52 Ibid.

53 Indeksi i Transparency International https://www.transparency.org/files/content/pages/2018_CPI_Executive_Summary.pdf

MIGRIMI DHE REZILIENCA

Në pyetjen se a ndjeheni të sigurt ju dhe familja e juaj me jetën dhe të ardhmen tuaj në Kosovë, 37 % e të anketuarve u shprehën se ata dhe familja e tyre ndihen të pasigurt që të planifikojnë jetesën e tyre në Kosovë, kurse pjesa tjetër apo 34 % e të anketuarve u shprehën se ndihen të sigurtë në planifikimin e jetës për vetën dhe familjen e tyre në vend. 28 % e të anketuarve u shprehën se ndihen mesatarisht të sigurtë në planifikimin e tyre të jetës në Kosovë dhe se edhe për një kohë nuk e mendojnë largimin e tyre nga Kosova.⁵⁴ Si mungesë e sigurisë për të jetuar në Kosovë, vendi është përballur me migrim shumë të madh e cila ka ndikuar zvogëlimin total të popullatës me mbi 15 % në dekadën e fundit për shkak të sistemit jo të mirë të edukimit, mundësitë e vogla për punësim si dhe shtetit të kapur. Sipas të dhënave të Eurostatit të vitit 2018, si shkak i Migrimit, popullsia e Kosovës është ulur me 15.4 % brenda dekadës si shkak i migrimit kryesisht të popullatës së re.⁵⁵ Mungesa e besimit në shtet si dhe ndjenja e pasigurisë për jetë në Kosovë e bënë popullatën më të cenushme ndaj formave të ndryshme të radikalizmit dhe ekstremizmit.




Figura 14-Sa ndiheni te sigurve te jetoni ne Kosove

54 Ibid:

55 The Guardian "Europe's south and east worry more about emigration than immigration- Poll" 2019 https://www.theguardian.com/world/2019/apr/01/europe-south-and-east-worry-more-about-emigration-than-immigration-poll?CMP=Share_iOSApp_Other




Figura 15- te dhenat e EUROSTAT rreth shkalles se migrimet te popullsise se Kosoves ne dekadene e fundit.

Burimi- Guardian graphic. Source Eurostat

Zhënjimi i komunitetit me institucionet e shtetit dhe me Kosovën, i bënë komunitetet e cënueshme ndaj ekstremizmit dhe radikalizmit. Reziliencia e komunitetit kundër dhunës dhe radikalizmit është e lidhur ngushtë me afërsinë e qytetarëve me vendin ku jetojnë si dhe besimin e tyre në institucionet qeverisëse të vendit. Në mungesë të saj qytetarët kërkojnë alternativa tjera që u mundëson atyre një jetesë më të mirë, si dhe arritjen e qëllimeve jetësore të tyre. Dëshira për një alternative të re për një jetë më të mirë, si dhe mungesë të sigurisë dhe besimit në shtetin e Kosovës, i bënë të komunitetin të cënueshëm prej ekstremizmit dhe radikalizmit.

3. BASHKËJETESA FETARE NË KOSOVË

3.1 LIRITË FETARE DHE BASHKËJETESË NDËRMJET FEVE

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendi ynë është shtet laik dhe neutral në **çështjet** fetare.⁵⁶ Poashtu Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare të vendit.⁵⁷ Bazuar në Kushtetutë, Kosova siguron dhe mbron monumentet fetare brenda territorit të saj. Ajo poashtu siguron që konfesionet fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm, veprimtaritë fetare, si dhe ritet fetare.⁵⁸

Sipas Kushtetutës, “Republika e Kosovës do të promovoj ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet”.⁵⁹

Legjislacioni i Kosovës, duke përfshirë Kushtetutën e Kosovës siguron që çdo individ mund të praktikoj të drejtat dhe liritë fetare deri në atë masë që nuk rrezikohet rendi kushtetues dhe i sigurisë në Kosovë.⁶⁰ Për më shumë të drejtat dhe liritë fetare të praktikuesve në Kosovë, u janë të garantuara edhe me legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, dokumente të cilave u sub-ordinohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës.⁶¹

Bazuar në regjistrimin e popullsisë në Kosovë të kryer nga Qeveria, në Kosovë janë rreth 1.9 milion banor. Duke u bazuar në këto të dhëna rreth 94 % e të regjistruarve janë deklaruar si Mysliman, 2,2 për qind si katolikë, 4 për qind si serbë ortodoksë.⁶² Bojkotimi i regjistrimit

56 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 8.

57 Ibid. neni 9.

58 Ibid. neni 39.

59 Ibid. neni, 58

60 Ibid.

61 Ibid;

62 Agjencia e Statistikave të Kosovës “Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011”

nga ana e serbëve rezultoi në llogaritje shumë më të ulët të anëtarëve të komunitetit serb në Kosovë. Regjistrimi popullsisë është kritikuar nga përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë, sidomos Bashkësisë së Tarikatëve të Kosovës dhe Kishës Protestante. Sipas tyre regjistrimi i popullsisë në Kosovë, sa i përket përkatësisë fetare (praktikues dhe jo-praktikues) nuk është i saktë. Bashkësitë e tjera fetare si: protestante, bashkësitë e tarikateve në Kosovë dhe të tjera mendojnë se kanë më shumë anëtarë, të cilat nuk janë reflektuar në procesin e regjistrimit të popullsisë.⁶³

3.2 BESUESHMËRIA NË BASHKËSITË FETARE

Bashkëjetesa fetare në Kosovë është njëra ndër vlerat më të mëdha dhe unike në Kosovë, dhe e cila e ka ndihmuar vendin në krijimin e një komuniteti të shëndosh dhe rezistent ndaj dhunës dhe radikalizmit me bazë fenë. Nuk ka përplasje fetare ndërmjet komuniteteve të besimeve të ndryshme në Kosovë. Edhe kur raportohen rastet e tilla, ato ndërlihen kryesisht me dëmtim të pronës së bashkësive fetare apo vjedhje brenda objekteve fetare. Këto raste kanë qenë të vogla dhe nuk kanë mundur të dëmtojnë harmoninë fetare në Kosovë.

Në vitin 2018 në Policinë e Kosovës ishin raportuar 86 incidente të vogla me karakter fetar. Shumica e rasteve lidheshin me dëmtim të pronës të objekteve fetare apo vjedhjeve. Prej tyre, 59 raste i përkisnin Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) 23 raste të Kishës Ortodokse Serbe, dhe katër për Kishën Katolike në Kosovë.⁶⁴

Feja dhe praktikimi i saj tek të gjitha besimet në Kosovë është i lidhur ngushte me historinë e Kosovës, kulturën, traditën fetare dhe kombëtare të saj. Këto elemente kanë qenë përcaktuese që Kosova të jetë ndër vendet e rralla në botë ku komunitetet e besimeve të ndryshme fetare mund të jetojnë në një paqe dhe harmoni të plotë.

Harmonia e madhe fetare në Kosovë tentoi të priset pas përfundimit të konfliktit në Kosovë në vitin 1999. Në këtë kohë, u krijua një ambient i përshtatshëm për organizata të ndryshme humanitare të cilët nën petkun e ndihmave për popullatën e varfër në vend, investuan edhe në përhapjen e elementeve radikale të religjionit islam në Kosovë, krejt kjo si këmbim për

63 Intervistë me udhëheqësin e Bashkësisë së Tarikatëve të Kosovës, Prishtinë Mars 2020

64 KOSOVO 2018 INTERNATIONAL RELIGIOUS FREEDOM REPORT

ndihmën humanitare.⁶⁵ Mëse shumti është vërejtur prania e organizatave fetare dhe fondacioneve nga Lindja e Mesme të cilat investuan në masë të madhe në përhapjen e religjionit në Kosovë, edukimin e imamëve të vendit, si dhe ndërtimin e ri-ndërtimin e xhamive të shkatërruara gjatë luftës në Kosovë.⁶⁶

Mirëpo në mesin e organizatave humanitare kishte edhe prej atyre që nën petkun e gjendjes dhe nevojës humanitare në Kosovë kanë punuar në radikalizimin e popullatës duke përhapur elemente radikale të religjionit islam brenda popullatës së Kosovës të cilat ishin jashtë kontekstit të Kosovës, jashtë kulturës dhe traditës të saj, dhe të panjohura për vendin deri në atë kohë.⁶⁷ Për më shumë, “rikthimi në fe” i praktikuesve të rinjë fetar të Kosovës siç ëshë pretenduar nga disa, e ka kthyer religjionin për një pjesë shumë të vogël të komunitetit të Kosovës edhe si mënyrë të jetës, dhe ka larguar traditën e praktikën fetare që këto familje e kanë pasur në të kaluarën.⁶⁸

Përkundër përpjekjeve për përhapjen e elementeve radikale religjioze brenda Kosovës, një gjë e tillë nuk ka ndodhur në atë masë saqë të ketë ndonjë impakt të madh në mesin e komunitetit islam në Kosovë apo të dëmtoj bashkëjetesën fetare në vend. Komunitetet mbeten ende tolerante fetarisht dhe të hapura ndaj besimeve tjera, falë traditës së gjatë të praktikimit fetar që kanë qytetarët e Kosovës. Për më shumë, besimtarët mysliman në vend, praktikën fetare e kanë të lidhur ngushte elementin kombëtar, kulturor e tradicional të Kosovës. Një mishërim i tillë ndërmjet elementit fetar e kombëtar ka bërë që shoqëria kosovare të jetë shumë e qëndrueshme dhe e mbrojtur nga elementet radikale fetare.⁶⁹

Përderisa kemi tolerancë të plotë ndërmjet feve në Kosovë, janë vërejtur përplasje të ndryshme brenda religjioneve sidomos brenda BIK-ut. Si shkak i problemeve ende të panjohura mirë për publikun, brenda BIK janë krijuar dy grupe të cilët për një kohë të gjatë e luftojnë njëri tjetrin.⁷⁰

65 QKSS “Shkaktarët e Përfshirjes së qytetarëve të Kosovës në luftërat e huaja në mënyrë të pa autorizuar. Prishtina, Pril 2015

66 Krasniqi Gezim 2015.

67 (Blumi 2005, 2)

68 Intervistë me një udhëheqës të lartë të Bashkësisë Islame të Kosovës. Prishtinë, Nëntor 2019.

69 Diaspora dhe ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë. KCSS 2020

70 Ibid.

Këto përplasje të brendshme brenda BIK në Kosovë, kanë ndikuar në shumë raste që myslimanet praktikues të Kosovës janë përplasur ndërmjet vetes se cili imam duhet të shërbejë në xhaminë e caktuar. Rastet të tilla janë përmendur në Gjilan, Suharekë, Viti, Kacanik, Pejë, Dragash, Ferizaj, Mitrovicë, e shumë lokalitete të ndryshme të Kosovës, ku komuniteti fetar është ndarë në dy grupe dhe që ritualet fetare në këto xhami kryhen ndaras.⁷¹ Përplasjet e tilla kanë ndikuar në zbehjen e besimit të komunitetit mysliman të Kosovës brenda Bashkësisë Islame të Kosovës si dhe fragmentalizmin e komunitetit praktikues islam në vend.⁷²

Përplasje të mëdha janë duke ndodhur edhe ndërmjet BIK si dhe Bashkësisë së Tarikatëve të Kosovës. Bashkësia e Tarikatëve të Kosovës nuk dëshiron të jetë nën ombrellën e BIK, dhe se janë deklaruar si bashkësi e pavarur fetare. Këto dy bashkësi fetare përplasjet e tyre i bëjnë kryesisht për të ashtuquajturave “problemeve ideologjike” përplasje për të cilat nuk kanë ofruar argumente serioze asnjëra palë.⁷³

Kosova njihet për një bashkëjetesë të mirë fetare ndërmjet komuniteteve të ndryshme. Tek shumica e praktikuesve religjioz në Kosovë, sidomos atyre mysliman është ruajtur tradita e praktikimit të islamit në Kosovë, e cila është e mishëruar me elementin kulturor, historik e kombëtar të vendit. Kjo qasje ka ndikuar që shoqëria kosovare të jetë më reziliente ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Përderisa në Kosovë ka tolerancë të madhe ndërmjet feve, sfidë mbeten përplasjet brenda sekteve fetare në Kosovë, sidomos përbrenda Bashkësisë Islame të Kosovës për shkak të grupeve të ndryshme të interesit brenda BIK, si dhe agjendave të tyre. Poashtu edhe Bashkësia e Tarikateve të Kosovës ka përplasje të mëdha me BIK.

Përplasjet ndërmjet BIK si dhe sekteve brenda saj, rrisin potencialin për përhapje të ekstremizmit dhe radikalizmit në vend, qoftë duke krijuar grupe apo institucione paralele religjioze në Kosovë, të cilët kryejnë rituale fetare në Kosovë jashtë rregullave dhe praktikave të krijuara nga ana e BIK. Kjo rritë potencialin për përhapje të ekstremizmit dhe radikalizmit në emër të keqpërdorimit të fesë, ashtu siç ka ndodhur në pas shpalljes së pavarësisë.

71 QKSS “Shkaktarët e Përfshirjes së qytetarëve të Kosovës në luftërat e huaja në mënyrë të pa autorizuar. Prishtina, Pril 2015

72 Ibid.

73 I Intervistë me një zytar të lartë të Bashkësisë Islamë të Kosovës. Prishtinë, dhjetor 2019 dhe interviste me perfaqesuesin e Bashkësisë së Tarikateve të Kosovës Mars 2020.

REKOMANDIMET

- a) Duhet të punohet në ngritjen e vetëdijesimit tek familja dhe komuniteti kur në mesin e tyre hasim në individ që shpërfaqin shenjat e hershme të radikalizmit. Ndaj tyre nuk duhet të ushtrohet dhunë apo presion. Anëtarët e familjes dhe komunitetit duhet të pajisen me njohuritë e duhura se si duhet të reagohet kur hasin në individ që shpërfaqin shenjat e hershme të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm tek familjaret apo të afërmit e tyre. Hartimi i një manuali për komunitetin dhe familjen që shpjegon mënyrën e reagimit ndaj individëve që kanë shenjat e hershme të radikalizmit është shumë i nevojshëm dhe do të ndihmonte në parandalimin e hershëm e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit si dhe do të forconte reziliencën e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit;
- b) Ekziston një besim shumë i ulët ndërmjet komunitetit dhe institucioneve të shtetit në nivel qendror dhe lokal cili krijon hapësirë të përshtatshme për involvim të akterëve të ndryshëm me elementë të dyshimtë radikal brenda komunitetit. Institucionet e shtetit (niveli qendror e lokal) duhet të rrisin bashkëpunimin me komunikimin me komunitetin që të jenë më afër tyre edhe në adresimin e shqetësimeve të qytetarëve. Kjo qasje ndikon në rritjen e sigurisë në komunitet si dhe parandalon përfshirjen e elementeve radikal të jashtëm brenda komunitetit në vend;
- c) Historia, kultura lokale, tradita si dhe identiteti kombëtar e kanë shoqëruar praktikimin e religjionit në Kosovë, çka ka bere që shqiptaret të jenë ndër popujt e rrallë në botë që kanë harmoni të plotë fetare. Kjo qasje duhet të forcohet tutje, duke parandaluar tendencat e individëve dhe organizatave me elemente të dyshimta radikale për të dobësuar kohezionin shoqëror në Kosovë nëpërmjet futjeve të elementeve radikal religjioz. Në këtë drejtim duhet të kontribuojnë institucionet fetare, shtetërore dhe komuniteti.
- d) Komuniteti në Kosovë nuk ofron hapësirë të lirë dhe të mjaftueshme për shprehjen e bindjeve politike apo fetare në Kosovë. Një përqindje solide e të anketuarve (afro 20 %) treguan se nuk ndihen të lirë të shprehin orientimin e tyre politik apo bindjet e tyre fetare më pjesën tjetër të komunitetit. Duhet të mbështeten dhe promovohen më

shumë iniciativa lokale të cilat promovojnë diverzitetin në nivel komuniteti me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurve dhe të lirë për shprehjen e orientimit politik e bindjeve fetare. Duhet të rritet mbështetja për organizatat jo qeveritare me bazë në komunitet me qëllim të luftimit të elementeve radikale dhe konservatorë brenda shoqërisë;

- e) Në Kosovë ka një harmoni të shumë të mirë fetare, dhe se problemet me karakter religjioz janë shumë të vogla në vend, të cilat nuk e prekin karakterin e bashkëjetesës së mirë fetare e cila ekziston në Kosovë. Janë vërejtur përplasje brenda bashkësive fetare në Kosovë, sidomos brenda komunitetit praktikues mysliman në Kosovë. Përplasje brenda BIK kanë ndikuar në ndarjen e praktikuesve mysliman në vend. BIK duhet të gjejë rrugë për luftimin e grupeve të imamëve brenda BIK, të reflektoj unitet duke pasur në fokus kryesor organizimin e mirëfilltë të jetës fetare në Kosovë, dhe parandalimin e çdo elementi radikal në vend. Ndarjet dhe përplasjet brenda komunitetit mysliman në Kosovë. Prezenca e përplasjeve brenda bashkësive fetare në Kosovë rritë potencialin për radikalizëm në komunitet, si dhe e bene komunitetin më të cënueshëm ndaj formave të ndryshme të ekstremizmit religjioz;
- f) Zhvillimi i mendimit kritik si shkaktar i reziliencës. Mungesa e zhvillimit të mendimit kritik është vërejtur si një ndër shkaktarët e përhapjes së formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Mbështetja e iniciativave të cilat forcojnë zhvillimin e mendimit kritik tek fëmijët që ndjekin shkollimin para-universitar dhe universitar është esenciale në krijimin e shoqërisë të shëndosh dhe e cila është rezistente ndaj të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës së bashku me nivelin lokal duhet ta vendos si prioritet zhvillimin e mendimit kritik tek fëmijët. Duhet të hartohet një strategji, të bazuar në aktivitete të detajuara për zhvillimin e mendimit kritik tek fëmijët.
- g) Strategjia lokale si shkaktar i reziliencës- Forcimi i mekanizmave lokal është ndër mënyrat më të mira për forcimin e reziliencës në nivel komuniteti. Niveli lokal duhet të ndërtoj planë konkrete minimum 3 vjeçare për të parandaluar të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Ky dokument duhet të shërbej si dokument bazë për të gjitha mekanizmat lokal të sigurisë si: KKS, EVSP, liderët lokal, OJQ lokale, policinë, e institucione tjera të cilat do të kenë aktivitete konkrete në drejtim të parandalimit të përhapjes së të gjitha formave të ekstremizmit dhe radikalizmit në vend;

- h) Besimi i ulët në institucionet e shtetit si dhe kapja e shtetit janë ndër shkaktarët kryesor të përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në vend. Kjo ka bërë që qytetarët të mos kenë siguri për jetën e tyre në Kosovë, si dhe i ka bërë ata që të kërkojnë alternativa tjera për një jetë më të mirë. Institucionet e Kosovës duhet që punojnë në krijojnë mundësi të barabarta në punësim, edukim, drejtësi, shëndetësi e shërbime tjerë me qëllim të rikthimit të besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit, të cilat ndihmojnë në krijimin e komunitetit rezilient ndaj formave të ndryshme të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
- i) Kultura si shkaktar të reziliencës. Përveç komunës së Prishtinës (kryeqytetit), në komunat tjera ka mungesë të organizimit të aktiviteteve kulturore për të rinjtë e këtyre komunave. Ministria e Kulturës në bashkëpunim me mekanizmat lokal për kulture dhe rini, duhet të fillojnë më organizimin e aktiviteteve kulturore në nivel lokal për të rinjtë e këtyre komunave. Rritja e organizimit të aktiviteteve kulturore për të rinjtë, do të promovonte diversitetin etnik, fetar e racor tek të rinjtë. Kjo do të ndikonte në zhvillimin kritik tek fëmijët, si shkaktar shumë i rëndësishëm i reziliencës për të rinjtë;
- j) Promovimi i punës vullnetare- puna vullnetare në nivel komuniteti është shumë pak e zhvilluar tek të rinjtë në vend. Promovimi i punës vullnetare, si dhe stimulimi i të rinjve për të marrë pjesë në punë dhe aktivitete vullnetare tek të rinjtë rrite bashkëpunimin e tyre me komunitetin, si dhe rrite ndenjen e përkatësisë tek të rinjtë. Kjo i bënë të rinjtë më përfshirë në çështjet e rëndësishme të komunitetit, si dhe krijon një zinxhir të bashkëpunimit në mes institucioneve lokale, komunitetit dhe të rinjve e cila është ndër format më të mira të forcimit të reziliencës së komunitetit dhe parandalimin e të gjitha formave të radikalizmit dhe ekstremizmit;

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

327(496.51:4/9)

Perteshi, Skënder

Confidencial / Skënder Përteshi. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2020. – 48 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-799-10-2

www.qkss.org

ISBN 978-9951-799-10-2



9 789951 799102